



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: Agroekonomisë

Programi: Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati BSc. **Granit Zymeri**, me titull: **“Preferencat e konsumatorëve ndaj disa produkteve perimore (Domatja, Speci, Patatja dhe Qepa) në rajonin e Prishtinës”** ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data **24/06/2024** deri me datë **01/07/2024**.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Dr. Arben Musliu - kryetar/anëtar
2. Prof. Asoc. Dr. Njazi Bytyqi - mentor/anëtar
3. Prof. Dr. Skender Kaçiu - anëtar.

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Asoc. Dr. Njazi Bytyqi, përmes e-mail adresës njazi.bytyqi@uni-pr.edu

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë !

ABSTRAKT

Ky punim analizon preferencat e konsumatorëve për perimet, e në veçanti domatet, specat, patatet dhe qepët. Qëllimi i punimit është të kuptojmë faktorët që ndikojnë në vendimmarrjet e konsumatorëve, duke përfshirë faktorët socio-ekonomik, sasinë, frekuencën e blerjeve, preferencat e perimeve vendore kundrejt atyre të importuar, çmimet, identifikimi i vendeve më të preferuara ku konsumatorët blejnë perime, paketimet si dhe preferencat gjatë sezoneve. Pyetësori i hulumtimit u dizajnuar që të mbledhim të dhëna nga 104 pjesëmarrës me vendbanim nga regjioni i Prishtinës si: Prishtina, Kastrioti, Lipjani, Besiana dhe Fushë Kosova. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se pjesëmarrësit preferojnë bindshëm produktet vendore, me 82.7% që tregojnë një preferencë të konsiderueshme ose shumë rëndësishme për perimet vendore. Për më tepër vërehet tek të anketuarit se ka ndryshime në shpeshësinë e konsumit të perimeve. Sipas të anketuarve një pjesë e tyre 47.1% konsumojnë perime 2-4 herë në javë dhe 39.4% e të anketuarve konsumojnë perime për çdo ditë. Gjetjet theksojnë gjithashtu rëndësinë e preferencave ku: 29.8% e pjesëmarrësve preferojnë domate, 30.8% e pjesëmarrësve preferojnë specat, 26.0% e pjesëmarrësve preferojnë patate si dhe vetëm 13.5% e pjesëmarrësve preferojnë qepët.

Statistikat përshkruese, T-testet, Anova, korrelacioni, testet chi-square dhe testet të tjera janë metodat statistikore të përdorura me softuer SPSS për të analizuar ndryshoret. Siç vërehet nga gjetjet shpeshësia e konsumit të perimeve shfaq ndryshime thelbësore midis niveleve të ardhurave. Testet Chi-square vënë në dukje një korrelacion të rëndësishëm midis qytetit të banimit dhe preferencës për perimet vendore kundrejt atyre të importuara. Analizat e korrelacionit vënë në dukje një ndërlidhje të rëndësishme midis niveleve të arsimit dhe të hyrave, ku si rrjedhojë sa më të larta të hyrat ka një prirje për të zgjedhur perime bazuar në karakteristikat që lidhen me shëndetin. Këto gjetje do të mund të kenë dobi për tregtarët dhe prodhuesit e perimeve që duan të tërheqin konsumatorët duke vënë në dukje avantazhet shëndetësore të prodhimeve dhe origjinën e tyre. Për më tepër, metodat për të përmirësuar qasjen dhe ekspozimin e prodhimeve vendore në tregjet mund të rrisin kënaqësinë dhe kërkesën e konsumatorëve. Ky punim tenton të ofron njohuri të thella se si sillen konsumatorët gjatë blerjes së perimeve, duke tentuar të hedhë themelet për më shumë hulumtime dhe aplikime të dobishme në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit dhe marketingun bujqësor në të ardhmen.

Fjalët kyçe: Preferencat e konsumatorëve, produktet perimore, Domatja, Speci, Patatja dhe Qepa, Rajoni i Prishtinës.